



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

RREGULLORE
PËR TATIMIN NË PRONËN E PALUAJTSHME PËR
VITIN 2020

Podujevë, nëntor 2019

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja c) dhe 40.2 shkronja a) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, nenin 9 të të Ligjit nr.06/L-005, për Tatimin në pronën e paluajtshme, dhe neneve 14, 15 parag. 2.3 dhe 34 parag. 2.1, të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 22 nëntor 2019, miratoi,

**RREGULLORE
PËR TATIMIN NË PRONËN E PALUAJTSHME
PËR VITIN 2020**

I.DISPOZITAT THEMELORE

Neni 1

Baza Tatimore

1. Për vitin 2020 zonat tatimore dhe nivelet e vlerave për M² në Komunën e Podujevës caktohen si vijon:

Kategoria e vlerës	Nivelet e Vlerave për M ²			
	Zona I	Zona II	Zona III	Zona IV
1. Pronë komerciale				
1.1. Shitore	650 €	600 €	550 €	360 €
1.2. Zyrë dhe lokale afariste	650 €	600 €	550 €	360 €
1.3. Restorant	650 €	600 €	550 €	360 €
1.4. Hotel	650 €	600 €	550 €	360 €
1.5. Objekt për magazinim komercial	150 €	150 €	100 €	100 €
1.6. Garazh komercial	50 €	50 €	50 €	50 €
1.7. Pishinë për shfrytëzim komercial	110 €	110 €	110 €	90 €
1.8. Fushë e hapur sportive	80 €	80 €	80 €	80 €
1.9. Fushë e mbyllur sportive	100 €	100 €	100 €	100 €
1.10. Pompë benzine	650 €	430 €	350 €	200 €
1.11. Objekt-komerciale e pashfrytëzuar 70%	650 €	600 €	550 €	360 €
2. Pronë industriale				
2.1. Fabrikë	150 €	150 €	150 €	150 €
2.2. Punishte	150 €	150 €	150 €	100 €
2.3. Objekt për magazinim industrial	150 €	150 €	100 €	100 €

2. Baza tatimore për të gjitha pronat që nuk janë përfshirë në këtë Rregullore, është e përcaktuar sipas Vlerësimit të Ministrisë së Financave – Departamenti i Tatimit në Pronë, përmes Raportit mbi vlerësimin e përgjithshëm për objektet rezidenciale në Komunën e Podujevës, bashkëngjitur në këtë Rregullore.

II. ZONAT TATIMORE

Neni 2

Përcaktimi i zonave tatimore

Në territorin e Komunës së Podujevës janë përcaktuar katër zona të cilat paraqesin në vlerën e njësave të objekteve, dhe atë:

1. Zona e parë përfshinë rrugët, si vijon;

“ZAHIR PAJAZITI” “XHEMAJL MUSTAFA” “NUHI GASHI” “ILIR KONUSHEFCI” “HAKIF ZEJNULLAHU” “BAHRI FAZLIU” “AFRIM ZHITIA” “SALI H ÇITAKU” “DR BAJRAM KRASNIQI” “XHA FER META” “19 QERSHORI” “BEDRI BAJRAMI” “AGRON RRAHMANI” “FAHRI FAZLIU” “RAMUSH RAMA” “LIRIA”.

2. Zona e dytë përfshinë rrugët, si vijon;

“2 KORRIKU” “28 NËNTORI” “ABIT SINANI” “ADEM PODJEVA” “AFRIM ZHITIA” “AGIM RAMADANI” “AHMET HAXHIU” “AHMET SHABANI” “ALI AJETI” “ANTON QETA” “ANTON ZAKON QAJUPI” “AVDYLL LALA” “AVNI RRUSTEMI” “AZEMINA DABINOVCI” “BAJRAM JETULLAHU” “BEDRI SOKOLI” “BEJTUSH PODJEVA” “BESNIK RESTELICA” “BILL KLINTON” “BISLIM E NEZIR RESTELICA” “DR. ALI HADRI” “DR. SHAQIR SHAQIRI” “EJUP SHALA” “ESAD MEKULI” “ESET MALOKU” “FAZLI FETAHU” “FEHMI ZYMERI” “GJON SERREQI” “GRYKA E LLAPIT” “HAJREDIN UKELLI” “HAJZER BEHRAMI” “HAKIF SHEHOLLI” “HAKIF ZEJNULLAHU” “HAMDİ MALOKU” “HASAN PRISHTINA” “IDRIZ HASANI” “ILIR KONUSHEFCI” “JOSIP V. RELA” “JUSUF KOLIÇI” “KAVAJA” “KONGRESI I MANASTIRIT” “KUVENDI I BUJANIT” “LLORDI BAJRON” “MANÇESTERI” “MARTIRËT BOGUJEVCI” “MARTIRËT DURIÇI” “MBRETËRESHA TEUTË” “MET PODJEVA” “MIRSAD GASHI” “MOLLA E KUQE” “MUHAMET ALIU” “MUSTAFË HOXHA” “NAIM KADRIU” “NAZIM GAFURRI” “NEODARDANIA” “NIMON ALIU” “NURË SHATRI” “PLAVA E GUCIA” “QEFER SADIKU” “RAGIP ÇITAKU” “RAMADAN M. SALIHU” “RAMADAN MURATI” “RAMË GOVORI” “RAMUSH RAMA” “SABEDIN HASANI” “SABIT KAPITI” “SAHIT FUSHA” “SALI H ÇITAKU” “SHABAN SHALA” “SHAKADIN BEHRAMI” “SHEFQET BULLIÇI” “SHOTË GALICA” “SKENDERBEU” “SYLEJMAN MEHMETI” “TAHIR SINANI” “TIRONA” “ULÇINI” “VËLLEZËRIT FRASHËRI” “VISAR THAÇI” “VLORA” “XHELADIN REKALIU” “XHEMAJL MUSTAFA” “XHON BELUSHI” “XHORXH BUSH” “ZAHIR PAJAZITI”.

3. Zona e tretë përfshinë rrugët, si vijon;

“AHMET POPOVA” “AJET DURIÇI” “ALBANA” “ARBËRIA” “AVDULLAH BESELICA” “AVDUSH HASANI” “AVDYLL LAHU” “BAHRIE AHMETI” “BAJRAM METOLLI” “BAJRUSH MURATI” “BEDRI AHMETI” “BEKIM LUSHAKU” “BETEJA E LLAPASHTIÇËS” “BRAHË HERTICA” “BUNA” “BUSH SFEQLA” “DËSHMORËT” “DËSHMORËT STUBLLA” “DËSHMORËT BABATINCA” “DR BAHTIR SHEHOLLI” “EDI DURHAM” “EDMOND HOXHA” “ELFIR BEHRAMI” “EMIN DURAKU” “ESET MALOKU” “FADIL TALLA” “FATMIR HYSANI” “FAVZI RAMA” “FEHMI AGANI” “FEHMI MIFTARI” “FEHMI PERANI” “FEHMI ZYMERI” “FITORJA” “GJERGJ FISHTA” “GRYKA E LLAPIT” “HAXHI SADRI BLAKU” “HABIB ZEKA” “HAKIF ZEJNULLAHU” “HAMIT ABDULLAHU” “HIMARA” “HYS POPOVA” “HYZRI TALLA” “IBRAHIM DEMOLLI” “IDRIZ HASANI” “ILIRIA” “ISMAIL QEMALI” “ISMAJL ABDULLAHU” “ISMET DËRGUTI” “JAHË FUSHA” “JASHAR EREBARA” “JUSUF GËRVALLA” “KADRI ZEKA” “KRUJA” “KUVENDI I LEZHËS” “LEKË DUKAGJINI” “LIDHJA E FSHATIT” “LUGINA E PRESHEVËS” “LULET E LIRISË” “MARIN BARLETI” “MBRETËRESHA TEUTË” “MBRETI BARDHYL” “MEDLIN OLBRAJT” “MON BALAJ” “MOTRAT QIRIAZI” “MULLA DEMA” “MURSEL DABINOVCI” “MUSTAFË BLAKU” “NAZMI GAFURRI” “NAZMI ISMAJLI” “NËNË TEREZA” “NIMON ALIU” “NURË SHATRI” “OSMAN POLLATA” “PRESPA” “PREVEZA” “QAMËRIA” “QËNDRESA” “RAIF HALITI” “RAMË GOVORI” “RAMË VLLASA” “SABIT RRAHIMI” “SALI ÇEKU” “SALI H BUQA” “SAMI RAMA” “SHKËLZEN HARADINAJ” “SHKËMBI” “SHOQATA VATRA” “SHTEGËTARËT E LIRISË” “SKENDER H GASHI” “SKENDERBEU” “SYLEJMAN MEHMETI” “UKSHIN HOTI” “UNIVERSI” “VËLLEZËRIT TOVËRLANI” “VILSON” “XHA FER RRAHMAN MEHMETI” “XHA FER UKA” “XHAVIT HAZIRI” “XHEVAT JUPOLLI” “YMER BEKTESHI” “28 NËNTORI”.

4. Zona e katërt përfshinë fshatrat jashtë zonave urbane, si vijon:

Bajçinë, Balloc, Barainë, Batllavë, Bellopojë, Bradash, Buricë, Bërvenik, Bllatë, Brainë, Brecë, Dobërdol, Dobratin, Dumosh, Dumnicë e Poshtme, Dumnicë e epërme, Dumosh, Dvorishtë, Dyzë, Gërdoc, Gllamnik, Godishnjak, Halabak, Kaçybeg, Katunishtë, Kërprimeh, Kunushec, Letanc, Livadic, Lladoc, Llapashticë e Poshtme, Llapashticë e Epërme, Llugë, Lluzhan, Llaushë, Lupç i Poshtëm, Lupç i Epërm, Merdar, Metehi, Obrançë, Orllan, Pakashticë e Poshtme, Pakashticë e Epërme, Penuhë, Peran, Revuç, Radujevcë, Sallabajë, Sfeçël, Shajkoc, Shakovicë, Shtedim, Siboc i Poshtëm, Siboc i Epërm, Surkish, Tërnavë, Zakut, Herticë, Kalaticë, Kushevicë, Majac, Metergoc, Miroc, Muhazob, Murgull, Orllan, Pollatë, Popovë, Potok, Përpellac, Rakinicë, Reqicë, Repë, Sylevicë, Sllatinë, Surdull, Tërnavicë, Turuqicë, Zhiti.

Neni 3

Normat Tatimore

Caktimi i normave tatimore për vitin 2020 për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë pronë publike, bëhet konform nenit 9 parag. 1, nën paragrafët 1.1 deri 1.9 të Ligjit nr.06/L-005, për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, si vijon:

Kategoria e Pronës	Norma tatimore
Për njësitë bujqësore të parcelave	0.15 %
Për njësitë bujqësore të objekteve	0.15 %
Për njësitë pyjore të parcelave	0.15 %
Për njësitë rezidenciale të parcelave	0.15 %
Për njësitë rezidenciale të objekteve	0.15 %
Për njësitë komerciale të parcelave	0.15 %
Për njësitë komerciale të objekteve	0.20 %
Për njësitë industriale të parcelave	0.15 %
Për njësitë industriale të objekteve	0.20 %

Neni 4

Zbatimi

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje kujdeset Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

Neni 5

Hyrja në fuqi

Rregullorja hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në web faqen zyrtare të Komunës, dhe në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, përkatësisht konform nenit 81 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafit 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, ndërsa fillon të zbatohet nga 01 janar 2020.

Nr.01-432/02-0089762/19

Podujevë,
22 nëntor 2019



Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
 Republika e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
 Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije
 Ministry of Finance
 Arkiva - Arhiva - Archive

Mjesa Org. 09
 Nr. Prot. 378
 Br. Prot. Prot. No:
 Nr. i fletëve 31.10.2019
 Dato Datum 31.10.2019
 Nr. i shtypjeve
 Nr. i kopjeve
 Nr. i shifrave
 Nr. i pagës.
 Djalise PRISHTINË/A



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave
 Ministarstvo Finansija - Ministry of Finance

Departamenti i Tatimit në Pronë - Odeljenje za porez na imovinu - Department of Property Tax

REFERENCË:	
PËR/ZA/TO:	z. Agim VELIU, Kryetar i Komunës, Podujevë
CC:	z. Isuf LATIFI, Drejtor për Buxhet dhe Financa z. Shpresa MALOKU, Menaxhere e Tatimit në Pronë
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Naim BAFTIU, Sekretar i Përgjithshëm, MF
NGA/OD/FROM:	Shkelzen MORINA, Drejtor i Departamentit të Tatimit në Pronë, MF
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport mbi vlerësimin e përgjithshëm për Objekte Rezidenciale për Komunën Podujevë
Nr. i zyrës:	Lokacioni:
Br. kancelarije:	Kucni:
Room No:	Extension:
DTP	MF
Data:	30 Tetor, 2019
Datum:	
Date:	

I nderuar Kryetar,

Departamenti i Tatimit në Pronë në Ministrinë e Financave në përputhje me nenin 18, paragrafi 5 dhe 6 i Ligjit Nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, ka nxjerrë raportin për Komunën e Podujevës mbi vlerësimin e përgjithshëm të pronave të paluajtshme, Kategoria e pronës Objekte Rezidenciale (bashkëngjitur kësaj shkrese), në kuadër të të cilit janë përcaktuar zonat e vlerave dhe nivelet e vlerave të pronave të paluajtshme që janë brenda territorit të komunës, në përputhje me nenin 17, paragrafi 1 i Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme.

Raporti i vlerësimit të përgjithshëm është nxjerr pas kryerjes së vlerësimit për të përcaktuar nivelet e vlerave për Shtëpi Familjare, Apartament, Garazhë për Shfrytëzim Privat dhe Objekt tjetër Rezidencial, kategori këto të përcaktuara në përputhje me nenin 4 të UA MF-Nr. 03/2018 për Metodologjinë e Vlerësimit.

Gjatë procesit të vlerësimit të pronave të paluajtshme Objekteve Rezidenciale, janë analizuar vlerësimet nga komuna përgjatë viteve të mëparshme deri në vitin 2019. Fillimisht është bërë identifikimi i zonës qendër (zona kryesore me çmimin më të lartë për M²) dhe përveç kësaj janë aplikuar koeficientet për derivimin e vlerave nga zona kryesore (zona qendër) në zonat tjera jashtë saj dhe zonat më të largëta.

Aktualisht tregu i pronave rezidenciale në Republikën e Kosovës është i mangët sa i përket kontratave të shitblerjeve gjë që e bën procesin e vlerësimit mjaft kompleks për të përcaktuar nivelin e përafërt të vlerës duke u bazuar në metodën e krahasimit të shitblerjeve. Gjithashtu përgjatë vitit 2019 ka qenë e pamundur krijimi i shtresës së hartës zonale veçmas për Objektet për

Shtëpi Familjare dhe gjithashtu për Apartament. Krijimi këtyre shtresave të hartave për vlerësim do të jetë i mundur gjatë viteve në vijim për të gjitha kategoritë e pronave.

Si rrjedhojë, në mungesë të shitjeve, përveç derivimit të vlerave kemi aplikuar edhe qasjen e simulimit të vlerave të tregut duke aplikuar koeficient për zona dhe nivele të vlerave për ta derivuar nivelin e vlerës nga zona kryesore e komunës (zona qendër) dhe zonat tjera brenda juridiksionit të komunës.

Gjatë procesit të vlerësimit, në mungesë të veglave për ti ndryshuar kufijtë e zonave të vlerave apo edhe krijimit të zonave të reja në mënyrë që të krijohet shtresë e veçantë e hartës zonale për kategoritë e pronave rezidenciale janë përdorur si zgjidhje zonat e njëjta me ato të krijuara për tokat rezidenciale, zonim dhe vlerësim ky i kryer gjatë vitit 2018 dhe i aplikuar për vitin 2019. Kjo, edhe për arsyen se vlera e tokës ndikon edhe në vlerën e objektit, në zonat ku vlera e parcelës rezidenciale është më e lartë, konsiderohet si faktor që ndikon gjithashtu në vlerën e objektit.

Gjatë viteve në vijim do të rishikohen zonat dhe nivelet e vlerave për pronat e paluajtshme të përcaktuara deri më tani, dhe atë, aty ku është e nevojshme ndryshimi i kufijve të zonave ekzistuese apo edhe krijimi i zonave të reja nëse një gjë të këtillë e kërkon tregu i lirë i shitjeve dhe ka informacion të bollshëm.

Për qëllime të tatimit në pronë aplikohet vlerësimi në masë i pronave të paluajtshme, ku pronat brenda një zone të caktuar gjeografike, të së njëjtës kategori vlere, kanë vlera tregu të përafërta e cila nënkupton se niveli i vlerës (çmimi për M²) është i njëjtë në atë zonë vlere të caktuar.

Tatimi në pronë në Republikën e Kosovës është i bazuar në vlerën e tregut, prandaj në të ardhmen për ne dhe Komunën mbetet synim përmirësimi dhe pasqyrimi i përafërt i shitjeve të ndodhura ku një pronë do të shkëmbehet në datën e vlerësimit, mes një shitësi dhe një blerësi të vullnetshëm, përmes një transaksioni ku ata nuk kanë lidhje me njëri tjetrin dhe pasi të jetë bërë marketingu i duhur ku secila nga të dyja palët ka vepruar në mënyrë të vetëdijshme, me maturi dhe pa ndonjë detyrim.

Gjatë periudhës sa është punuar në vlerësimin e pronave rezidenciale janë zhvilluar takime me zyrtarët e Zyrave për Tatimin në Pronë të komunës për të koordinuar dhe harmonizuar idetë, propozimet dhe sugjerimet në lidhje me vlerësimin e kësaj kategorie të pronave për vitin e parë të vlerësimit në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Raporti mbi vlerësimin e përgjithshëm për Komunën Podujevë (bashkëngjitur kësaj shkrese) përmban informacionin si vijon:

- emrin e Komunës;
- datën e nxjerrjes;
- nivelin/nivelet e vlerës/vlerave për çdo zonë vlere;
- hartat e zonave të vlerave; dhe
- një përshkrim të çdo zone vlere;

Me respekt!



RAPORT MBI VLERËSIMIN E PËRGJITHSHËM

Komuna: PODUJEVË

Data e nxjerrjes: 30.10.2019

NJËSITË REZIDENCIALE TË OBJEKTEVE

- Niveli/Nivelet e vlerës/vlerave në çdo zonë vlere

Nivelet e Vlerave (€/m ²)					
PODUJEVË					
OBJEKTE REZIDENCIALE					
Numri i Zonës së Vlerës	Kategoria e Vlerës				
	Shtëpi familjare	Apartament	Garazh për shfrytëzim privat	Objekt tjetër rezidencial	
1801	€ 325.00	€ 350.00	€ 110.00	€ 160.00	
1802	€ 275.00	€ 300.00	€ 95.00	€ 140.00	
1803	€ 275.00	€ 300.00	€ 95.00	€ 140.00	
1804	€ 275.00	€ 300.00	€ 95.00	€ 140.00	
1805	€ 230.00	€ 250.00	€ 80.00	€ 120.00	
1806	€ 230.00	€ 250.00	€ 80.00	€ 120.00	
1807	€ 275.00	€ 300.00	€ 95.00	€ 140.00	
1808	€ 180.00	€ 190.00	€ 60.00	€ 90.00	
1809	€ 200.00	€ 220.00	€ 70.00	€ 100.00	
1810	€ 230.00	€ 250.00	€ 80.00	€ 120.00	
1811	€ 200.00	€ 220.00	€ 70.00	€ 100.00	
1812	€ 200.00	€ 220.00	€ 70.00	€ 100.00	
1813	€ 200.00	€ 220.00	€ 70.00	€ 100.00	
1814	€ 180.00	€ 190.00	€ 60.00	€ 90.00	
1815	€ 180.00	€ 190.00	€ 60.00	€ 90.00	
1816	€ 180.00	€ 190.00	€ 60.00	€ 90.00	
1817	€ 180.00	€ 190.00	€ 60.00	€ 90.00	



Harta e zonave të vlerave



PËRSHKRIMI I ZONAVE TË VLERAVE

Numri i zonës së vlerës: 1801

1. **Emri i zonës së vlerës:** Qendra.
2. **Përshkrim i zonës së vlerës:** Kjo zonë e vlerës përfshinë qendrën e qytetit dhe karakterizohet si zona më kryesore e komunës, e zhvilluar për nga infrastruktura dhe shërbimet publike të cilat mirëmbahen në mënyrë të veçantë për dallim nga zonat tjera. Popullimi dhe frekuentimi i qytetarëve në këtë zonë është më i theksuar.
3. **Të dhënat e shitblerjeve:** Nuk ka të dhëna.
4. **Vlerësimi:** Niveli i derivuar i vlerës përmes koeficienteve dhe simulimi i tregut.
5. **Burimi i informatave:** Baza tatimore e aplikuar nga Zyra e Tatimit në Pronë dhe intervistat.

Numri i zonës së vlerës: 1802

1. **Emri i zonës së vlerës:** Terminali Doganor.
2. **Përshkrim i zonës së vlerës:** Shtrihet rreth qendrës në drejtim të terminalit doganor deri të magjistralla Prishtinë-Merdare. Është e zhvilluar për nga infrastruktura dhe shërbimet publike të cilat mirëmbahen në mënyrë të rregullt. Popullimi dhe frekuentimi i qytetarëve në këtë zonë është i theksuar.
3. **Të dhënat e shitblerjeve:** Nuk ka të dhëna.
4. **Vlerësimi:** Niveli i derivuar i vlerës përmes koeficienteve dhe simulimi i tregut.
5. **Burimi i informatave:** Baza tatimore e aplikuar nga Zyra e Tatimit në Pronë dhe intervistat.

Numri i zonës së vlerës: 1803

1. **Emri i zonës së vlerës:** Qendër Perëndim.
2. **Përshkrim i zonës së vlerës:** Pjesa e qytetit në perëndim e cila kufizohet me zonën qendër (zonën kryesore), e zhvilluar për nga infrastruktura dhe shërbimet publike të cilat mirëmbahen në mënyrë të rregullt. Popullimi dhe frekuentimi i qytetarëve në këtë zonë është i theksuar.
3. **Të dhënat e shitblerjeve:** Nuk ka të dhëna.
4. **Vlerësimi:** Niveli i derivuar i vlerës përmes koeficienteve dhe simulimi i tregut.
5. **Burimi i informatave:** Baza tatimore e aplikuar nga Zyra e Tatimit në Pronë dhe intervistat.

Numri i zonës së vlerës: 1804

1. **Emri i zonës së vlerës:** ETC dhe Rrjedha e Lumit Llap.
2. **Përshkrim i zonës së vlerës:** Zona afër qendrës dhe shtrihet gjatë rrugëve kryesore që lidhin Podujevën me magjistrallen Prishtinë-Merdare. E zhvilluar për nga infrastruktura dhe shërbimet publike të cilat mirëmbahen në mënyrë të rregullt. Popullimi dhe frekuentimi i qytetarëve në këtë zonë është i theksuar.
3. **Të dhënat e shitblerjeve:** Nuk ka të dhëna.
4. **Vlerësimi:** Niveli i derivuar i vlerës përmes koeficienteve dhe simulimi i tregut.
5. **Burimi i informatave:** Baza tatimore e aplikuar nga Zyra e Tatimit në Pronë dhe intervistat.

Numri i zonës së vlerësimit: 1805

1. **Emri i zonës së vlerës:** Lagjja e Bebusheve.
2. **Përshkrim i zonës së vlerës:** Pjesa rreth qytetit në anën e djathtë të magjistrale Prishtinë-Merdare. E zhvilluar për nga infrastruktura dhe shërbimet publike të cilat mirëmbahen në mënyrë të rregullt. Popullimi dhe frekuentimi i qytetarëve në këtë zonë është i theksuar.
3. **Të dhënat e shitblerjeve:** Nuk ka të dhëna.
4. **Vlerësimi:** Niveli i derivuar i vlerës përmes koeficienteve dhe simulimi i tregut.
5. **Burimi i informatave:** Baza tatimore e aplikuar nga Zyra e Tatimit në Pronë dhe intervistat.



Numri i zonës së vlerës: 1806

1. **Emri i zonës së vlerës:** Lagjja Kuvajti.
2. **Përshkrim i zonës së vlerës:** Periferia e qytetit deri në kufi me lagjen Kuvajti, me infrastrukturë që mirëmbahet në mënyre të rregullt, kryesisht me shtëpi familjare.
3. **Të dhënat e shitblerjeve:** Nuk ka të dhëna.
4. **Vlerësimi:** Niveli i derivuar i vlerës përmes koeficienteve dhe simulimi i tregut.
5. **Burimi i informatave:** Baza tatimore e aplikuar nga Zyra e Tatimit në Pronë dhe intervistat.

Numri i zonës së vlerës: 1807

1. **Emri i zonës së vlerës:** Qendra Lindore.
2. **Përshkrim i zonës së vlerës:** Pjesa Veri-Lindore e qytetit që kufizohet me qendrën, e cila ka infrastrukturë që mirëmbahet në mënyrë të rregullt. Popullimi dhe frekuentimi i qytetarëve në këtë zonë është i theksuar, kryesisht me shtëpi familjare.
3. **Të dhënat e shitblerjeve:** Nuk ka të dhëna.
4. **Vlerësimi:** Niveli i derivuar i vlerës përmes koeficienteve dhe simulimi i tregut.
5. **Burimi i informatave:** Baza tatimore e aplikuar nga Zyra e Tatimit në Pronë dhe intervistat.

Numri i zonës së vlerës: 1808

1. **Emri i zonës së vlerës:** Murgullë, Dumnicë, Dobratin.
2. **Përshkrim i zonës së vlerës:** Pjesa periferike e komunës së Podujevës që kufizohet me Mitrovicën dhe Leposaviqin. Karakterizohet me fshatra të shpërndara, kryesisht shtëpi familjare.
3. **Të dhënat e shitblerjeve:** Nuk ka të dhëna.
4. **Vlerësimi:** Niveli i derivuar i vlerës përmes koeficienteve dhe simulimi i tregut.
5. **Burimi i informatave:** Baza tatimore e aplikuar nga Zyra e Tatimit në Pronë dhe intervistat.

Numri i zonës së vlerës: 1809

1. **Emri i zonës së vlerës:** Bradash, Bajçinë, Velikarekë, Llapashticë e Epërme.
2. **Përshkrim i zonës së vlerës:** Periferia e perëndimore komunës së Podujevës, brenda së cilës janë disa fshatra, kryesisht shtëpi familjare.
3. **Të dhënat e shitblerjeve:** Nuk ka të dhëna.
4. **Vlerësimi:** Niveli i derivuar i vlerës përmes koeficienteve dhe simulimi i tregut.
5. **Burimi i informatave:** Baza tatimore e aplikuar nga Zyra e Tatimit në Pronë dhe intervistat.

Numri i zonës së vlerës: 1810

1. **Emri i zonës së vlerës:** Letancë, Peran, Obrance, Pjesa Jugore e Dumnicës së Poshtme, Shtedim, Surkish, Gllamnik, Llapashticë e Poshtme.
2. **Përshkrim i zonës së vlerës:** Kjo zonë shtrihet rreth qytetit të Podujevës, brenda së cilës janë disa fshatra të shpërndara. Karakterizohet me ndërtime të ulëta, kryesisht shtëpi familjare.
3. **Të dhënat e shitblerjeve:** Nuk ka të dhëna.
4. **Vlerësimi:** Niveli i derivuar i vlerës përmes koeficienteve dhe simulimi i tregut.
5. **Burimi i informatave:** Baza tatimore e aplikuar nga Zyra e Tatimit në Pronë dhe intervistat.

Numri i zonës së vlerës: 1811

1. **Emri i zonës së vlerës:** Siboc i Epërm, Kunushec, Penuhë, Lluzhan, Shakovicë, Lupç i Poshtëm, Sallabajë.
2. **Përshkrim i zonës së vlerës:** Periferia e komunës së Podujevës përgjatë rrugës Podujevë-Prishtinë deri në kufi me komunën e Prishtinës. Karakterizohet me ndërtime të ulëta, kryesisht shtëpi familjare.
3. **Të dhënat e shitblerjeve:** Nuk ka të dhëna.



4. **Vlerësimi:** Niveli i derivuar i vlerës përmes koeficienteve dhe simulimi i tregut.
5. **Burimi i informatave:** Baza tatimore e aplikuar nga Zyra e Tatimit në Pronë dhe intervistat.

Numri i zonës së vlerës: 1812

1. **Emri i zonës së vlerës:** Sfeçël, Dumosh, Siboc i Poshtëm, Kaçibeg, Llugë, Balloc.
2. **Përshkrim i zonës së vlerës:** Shtrihet në pjesën lindore të Podujevës, brenda së cilës janë disa fshatra të shpërndara. Karakterizohen me ndërtime të ulëta, kryesisht shtëpi familjare.
3. **Të dhënat e shitblerjeve:** Nuk ka të dhëna.
4. **Vlerësimi:** Niveli i derivuar i vlerës përmes koeficienteve dhe simulimi i tregut.
5. **Burimi i informatave:** Baza tatimore e aplikuar nga Zyra e Tatimit në Pronë dhe intervistat.

Numri i zonës së vlerës: 1813

1. **Emri i zonës së vlerës:** Miroc, Merdar, Lladoc, Shajkoc, Batllavë, Gërdoc, Bellopojë, Radujec.
2. **Përshkrim i zonës së vlerësimit:** Shtrihet në pjesën më të largët lindore të Podujevës. Brenda së cilës janë disa fshatra të shpërndara. Karakterizohen me ndërtime të ulëta, kryesisht shtëpi familjare.
3. **Të dhënat e shitblerjeve:** Nuk ka të dhëna.
4. **Vlerësimi:** Niveli i derivuar i vlerës përmes koeficienteve dhe simulimi i tregut.
5. **Burimi i informatave:** Baza tatimore e aplikuar nga Zyra e Tatimit në Pronë dhe intervistat.

Numri i zonës së vlerës: 1814


1. **Emri i zonës së vlerës:** Orllan.
2. **Përshkrim i zonës së vlerës:** Pjesa periferike e komunës së Podujevës, saktësisht zona rreth liqenit të Batllavës, ka të ndërtuara shtëpi familjare.
3. **Të dhënat e shitblerjeve:** Nuk ka të dhëna.
4. **Vlerësimi:** Niveli i derivuar i vlerës përmes koeficienteve dhe simulimi i tregut.
5. **Burimi i informatave:** Baza tatimore e aplikuar nga Zyra e Tatimit në Pronë dhe intervistat.

Numri i zonës së vlerës: 1815

1. **Emri i zonës së vlerës:** Tërnavë, Halabak.
2. **Përshkrim i zonës së vlerës:** Periferia e komunës së Podujevës e cila kufizohet me komunën e Vushtrrisë, vendbanimet janë të shtrira përgjatë luginës, kryesisht me shtëpi familjare.
3. **Të dhënat e shitblerjeve:** Nuk ka të dhëna.
4. **Vlerësimi:** Niveli i derivuar i vlerës përmes koeficienteve dhe simulimi i tregut.
5. **Burimi i informatave:** Baza tatimore e aplikuar nga Zyra e Tatimit në Pronë dhe intervistat.

Numri i zonës së vlerës: 1816

1. **Emri i zonës së vlerës:** Dyz, Herticë, Surdull, Turuçica, Rakinicë, Bërvenik, Kushevicë, Brainë.
2. **Përshkrim i zonës së vlerës:** Përfshinë hapësirat periferike të komunës së Podujevës e cila kufizohet me komunën e Prishtinës dhe karakterizohet më shumë me ndërtime të ulëta, kryesisht shtëpi familjare të shpërndara brenda zonës.
3. **Të dhënat e shitblerjeve:** Nuk ka të dhëna.
4. **Vlerësimi:** Niveli i derivuar i vlerës përmes koeficienteve dhe simulimi i tregut.
5. **Burimi i informatave:** Baza tatimore e aplikuar nga Zyra e Tatimit në Pronë dhe intervistat.



Numri i zonës së vlerës: 1817

1. **Emri i zonës së vlerës:** Herticë, Turuçica, Brainë, Kushevicë.
2. **Përshkrim i zonës së vlerës:** Përfshinë hapësirat periferike të komunës së Podujevës e cila kufizohet me komunën e Prishtinës dhe karakterizohet më shumë si zonë kodrinoro-malore brenda së cilës ka pak ndërtime të ulëta, kryesisht janë shtëpi familjare.
3. **Të dhënat e shitblerjeve:** Nuk ka të dhëna.
4. **Vlerësimi:** Niveli i derivuar i vlerës përmes koeficienteve dhe simulimi i tregut.
5. **Burimi i informatave:** Baza tatimore e aplikuar nga Zyra e Tatimit në Pronë dhe intervistat.

Shkelzen MORINA

